



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health

Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine, datë: 11.06.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe Rregulloren për Prokurimin publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas dy kërkesës për ri-shqyrtim të datës 02.06.2025 të parashtruar nga: **Grup i OE Mabco Constructions & AAG Projekt & IMK, Grup i OE ADA & SHM Arch & Vllezerit Asllani ; BM Group**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull **“Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente ne QKUK”** me nr. prokurimi **206-23-14371-5-1-1**, nxjerr:

V E N D I M

- I. **Refuzohen**, si te pa bazuara (raste te gjykuara) tri kërkesat për rishqyrtim nga: **Grup i OE Mabco Constructions & AAG Projekt & IMK, Grup i OE ADA & SHM Arch & Vllezerit Asllani ; BM Group**, te datës 02.06.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **“Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente ne QKUK”** me nr. prokurimi **206-23-14371-5-1-1**, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK, të datës 28.05.2025 te publikuar ne platformën elektronike;
- II. **Vërtetohet**, Njoftimi mbi Vendimin e AK, i datës 28.05.2025;
- III. Autoriteti Kontraktues, e konsideron te mbyllur aktivitetin e prokurimit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Grup i OE Mabco Constructions & AAG Projekt & IMK, Grup i OE ADA & SHM Arch & Vllezerit Asllani ; BM Group, me datën 02.06.2025 kane parashtruar kërkesa për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente ne QKUK”** me nr. prokurimi **206-23-14371-5-1-1**. Autoriteti Kontraktues, me datën 05.06.2025, i ka shqyrtuar kërkesat në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga AK sipas Grup i OE Mabco Constructions & AAG Projekt & IMK,:

Ligji për Prokurim Publik i konsoliduar.

- Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi;
- Neni 52 Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës;
- Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve;
- Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit;
- Neni 69 Kapaciteti teknik dhe profesional;
- Neni 70 Standardet për Sigurimin e Cilësisë
- Neni 71 Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik;
- Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë.

Rregullorja nr. 001/2022, për Prokurim Publik

- Neni 38 Sqarimi i Tenderëve;
- Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve;
- Neni 43 – Nderprerja e Procedurave të Prokurimit.
- Neni 97 – Shkeljet e Renda

Udhëzuesi për Prokurim publik 001/2023.

- Neni 10 - Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve.

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga AK sipas Grup i OE ADA & SHM Arch & Vllezerit Asllani:

Vlerësojmë se janë shkelur dispozitat ligjore që rregullojnë:

- Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, sipas nenit 59 të ligjit, ndërlidhur me nenin 40 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.
- Dëshmitë e kërkesave, sipas nenit 64 të ligjit për prokurim publik.
- Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit sipas nenit 62 të ligjit

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga AK sipas OE BM Group SH.P.K.:

Autoriteti Kontraktues: Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë me publikimin e Njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ka bërë shkelje të:

Legjislacioni primar:

A. Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

Specifikisht të neneve:

Neni 6. Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 7. Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
Neni 59. Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve
Neni 62. Përfundimi i aktivitetit të prokurimit
Neni 69. Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
Neni 72. Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Legjislacionit sekondar:

B. A01. Rregullore Nr.001/2022 për Prokurimin Publik

Specifikisht të neneve:

Neni 40. Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

C. A02. Udhëzues Nr-001/2023 për prokurimin publik

Specifikisht të neneve:

Dispozitat e përgjithshme

1. Qëllimi dhe Fushëveprimi i Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik
10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve

Pretendimet ankimore sipas Grup i OE Mabco Constructions & AAG Projekt & IMK,:

Të nderuar,

Kjo procedure e prokurimit, kure është publikuar tani me ka kaluar me shume se një vit dhe ende nuk ka marr epilog si rezultat i prolongimit dhe shkeljeve ligjore. Juve si AK - Ministria e Shëndetësisë, më datën 02/04/2024, si fillim keni publikuar formularin B58 – Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, ku edhe atehere grupin tone të Operatorëve Ekonomik ankues “Mabco Construction” Sh.P.K., AAG Project & IMK” Sh.P.K. – Prishtinë, sipas letrës standarde e keni eliminuar kundërligjeshëm.

Kundërligjeshmëria e veprimeve në vlerësimin fillestarë ishte konfirmuar edhe në procedurën paraprake sipas ankesës sonë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit dhe atë me vendimin e datës 11.09.2024, dhe numër 2024/0352, ku ankesa jone ishte aprovuar si e bazuar dhe oferta jone ishte kualifikuar si e përgjegjeshme.

- **Prove:** Vendimi i datës 11.09.2024, me nr. PSH: 2024/0352

Grupi i Operatorëve Ekonomik ankues "Mabco Construction" Sh.P.K., AAG Project & IMK" Sh.P.K. – Prishtinë, konsideron se propozimi për anulim të procedurës së prokurimit i datës 28.05.2025, është i kunderligjeshëm, prandaj në afatin e paraparë me nenin 108/A të LPP-së, paraqesim kundër argumentet tona si më poshte:

Pretendimi ankimor 1.

Pas procesit të rivlerëimit të ofertave më datën 21.11.2024, juve si AK – MSH, keni nxjerre perseri njoftim dhe këtë procedure të prokurimit e keni anuluar kunderligjeshëm me arsyetimin se nuk ka oferta të përgjegjeshme si rrjedhojë edhe tani sipas vendmit tuaj të datës 28.05.2025, perseri si arsyetim të anulimit të procesit keni potencuar se nuk ka oferta të përgjegjeshme perderisa ndaj ofertës sonë nuk keni nxjerre fare leter standarde dhe nuk keni dhënë kurrefare arsyetimi për përgjegjeshmeri apo pa përgjegjeshmeri të ofertës sonë.

Neni 42, i Rregullores me nr. 001/2022, për Prokurim Publik paragrafi 1 dhe 3 përcaktojnë:

- 42.1 *Të gjithë tenderuesit/ kandidatët, duhet të informohen nga AK, përmes publikimit të Formularit B58 "Njoftimit mbi Vendimin e AK",*
- 42.3 *Formulari B58 duhet të përmbajë vendimin mbi rezultatin e aktivitetit të prokurimit dhe letrat standarde përkatëse për Tenderuesit me arsyetimet e nevojshme.*

Grupi ynë i OE-ve në procesin e ri vlerësimit të ofertave nuk ka pranuar leter standarde dhe neve si grup nuk jemi të njoftuar me arsyetimin e eliminimit pas procesit të rivlerësimit të ofertave pavarësisht faktit se jemi pjesë e procedurës dhe jemi pale me interes juridik bazuar në nenin 4.1.26, të LPP-së. Nxjerrja e letrës standarde është e obligueshme për secilin Autoritet Kontraktues përkatës.

Pretendimi ankimor 2:

Shkelja tjetër ligjore e Autoriteti Kontraktues MSH, në procedurën e ri vlerësimit të ofertave përsëri ka të bëjë me pa përgjegjësinë e zyrtarëve përgjegjës të prokurimit dhe anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave, përkatësisht tejkalimit të afatit ligjor për ri vlerëim të ofertave, pasi që Paneli Shqyrtues, më datën 02.04.2025, ka nxjerrë vendim ndaj kësaj procedure të prokurimit, perderisa njoftimi mbi vendimin e AK-së për ri vlerëim të ofertave është publikuar me datën 28.05.2025, ku edhe tani tentohet të anulohet procedura e prokurimit kundërligjeshëm.

Me nenin 59, të LPP-së është e përcaktuar periudha kohore e vlerësimit të ofertave, përkatësisht me nenin 40, paragrafi 3, të Rregullores me nr. 001/2022, kjo të përcaktohet që:

"Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, dhe nxjerrja e njoftimit mbi vendimin e AK, do të kryhet nga AK brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave..."

Ndërsa ju si Autoritet Kontraktues, për të ri vlerësuar procedurën e prokurimit përsëri i'u janë dashur mbi 60 ditë kalendrike. Kjo qeshtje është konsideruar shkelje ligjore me raportin e ekespertizes në procedurën paraprake të ndjekur në OSHP si dhe me vendimin të panelit

shqyrtues. Ne si operatore ekonomik ofertues pergjate procesist te ri vlerësimit nuk kemi pranuar kurrefarevendmi për vazhdim te afatit te rivlerësimit apo ndonje leter tjetër standarde sqaruese ndaj ofertës sonë.

Pretendimi ankimor 3:

Tani ne procedure te ri vlerësimit te ofertave neve si grup i OE-ve nuk jemi te njoftuar me arsyetimin e eliminimit te ofertës, perkateisht ri vlerësimin e te njejtës. Pavaresisht faktit se OSHP, gjegjesisht paneli shqyrtues ne vendimin e fundit ndaj ofertës sonë ka potencuar se *“ne Planin Dinamik të ofruar mungon pershkrimi i punimeve tek H4- ku nuk janë të përfshiera (mungojne) 14 pozicione. Sipas DT se ku është e paraqitur forma 1 dhe 2 lidhur me Planin Dinamik ky OE ka perdorur vetëm formën 1 por jo edhe te plotësuar ngase siq u tha edhe me larte mungon pershkrimi i dinamikës ne realizimin e punimeve nga H4 , në 14 37 pozicione, ndërsa forma 2 nuk gjendet fare, kështu që ky Plan i ofruar nga ankuesi, nuk është ofruar sipas kërkesës së DT dhe si i tillë nuk ofron të dhëna të sakta rreth implementimit të këtij projekti, përshtirë edhe afatet e ekzekutimit të punëve...”*, ne asnje rrethane nuk e bene ofertën tone te pa pergjegjeshme këto pohime, marre parasysh faktin se pohimet e tilla nuk kane kurrefare lidhje me gjendjen faktike te planit dinamik te prezantuar ne oferte. OSHP, me vendmimet e saja ne procedura tjera te prokurimit, pkanin dinamik e ka pranuar si dokument shtese dhe nuk e ka trajtuar si ndryshim material, planin dinamik me vendme tjera nuk e trajtuar si kerkese kualifikuese fare dhe ka gjykuar ndrsyhi nga vendimi i saje i fundit.

Madje ne këtë procedure te prokurimit pikerisht për plan dinamik paneli shqyrtues i OSHP- se ka dhënë interpretime dhe opinione te ndryshme.

- Ne vlerësimin fillestare është potencuar se nuk ekziston baze ligjore e qarte qe rregulon këtë qeshtje, me pastaj është kerkuar nga AK qe kjo qeshtje te sqarohet dhe te plotësohet dhe se fundmi potenncohet se plani nuk posedon pozicione te ndryshme sipas fazave te dinamikës se punes, pra paneli shqyrtues ne asnjeren nga fazat e vlerësimeve ne këtë procedure nuk ka qen konsistent për qeshtjen e planit dinamik dhe qeshtje tjera.
- Ngjashëm është vepruar edhe nga ekspert shqyrtues dhe profesional për këtë procedure te prokurimit, ku janë dhënë interpretime te ndryshme, si rrjedhoje ne këtë faze dhe pas kalimit te periudhes prej rreth 500 dite nga hapja e ofertave ne asnje rrethane plani dinamik i asnjeres kompani ofertuese ne këtë procedure te prokurimit nuk gjene zbatim dhe është i pa implementueshem.

Madje ne kemi dhënë përgjigje të detajuara ndaj kërkesës për sqarim lidhur me planin dinamik të prezantuar në ofertë. Plani dinamik është i krijuar përmes prorgamit përkates “Ms Project”, program ky i krijuar pikerisht për këtë qeshtje që ka të bëjnë me projekte inxhinierike, ku përfshinë me saktësi të gjitha hapat dhe veprimet e realizimit të punëve. Plani dinamik i dorezuar në ofertë i përmbanë të gjitha elementet, numrin e diteve dhe të gjitha veprimet tjera që nga fillimi i realizimit të projektit deri në përmbylljen e tij, si rrjedhoje arsyetimi i pershkruar ne vendimin e fundit te panelit shqyrtues lidhur me planin dinamik është i pa sakt dhe jo real, madje edhe jo konsistent me gjykimet paraprake te ankesave tona pikerisht për këtë qeshtje.

Sa i përket pozicionit H.4, tani të përshkruar, nuk është asgjë tjetër por vetëm tentativë për të eliminuar kundërligjshëm ofertën tonë. Ne si kompani edhe ndaj letrës standarde – kërkesës

për sqarimin e tenderit të aplikuar përgjatë ri vlerëimit të ofertave, kemi dhënë sqarime të detajuara, gjegjësisht realizimi i këtijë pozicioni është planifikuar të realizohet përmes realizimit të pozicioneve që kanë të bëjnë me instalimet e pozicionit H – hidronistalimet dhe ky arsyetim në asnjë rrethanë nuk mundë ta eliminoi kompaninë tone si të pa përgjegjeshme. Për më tepër kompani tjera pjesëmarrëse pikërisht në këtë procedurë të prokurimit shumë nga pozicionet dhe veprimet përgjatë realizimit të punëve nuk i kanë të përfshira por të njëjtat për këtë qeshtje nuk janë të eliminuara.

Përveq kësajë, si rezultat i neglizhences së zyrtareve përgjegjës të prokurimit, prolongimit të procedurës së prokurimit dhe veprimeve tjera kundërligjore të konsumuara nga Autoriteti Kontraktues – MSH, tani më i njëjti plan dinamik, nuk mundë të jetë si plan i zbatueshëm, meqë kthimi prapa në kohe është i pa mundur dhe detyrëmisht duhet të krijohet plan i ri, para nënshkrimit eventual të kontratës dhe se grupi i Operatorëve Ekonomik, ankues me përgjegjësi të plotë ligjore dhe profesionale do t'i përmbahet periudhës kohore të dhënë në planin dinamik të ofruar me ofertë.

Përveq kesajë me vendimin e OSHP-së, të datës 11.09.2024, me nr. 2024/0362, tek arsyetimi i të njëjtut kjarë trajtohet qështja e planit dinamik të kontestuar nga ne në vlerësim fillestar të ofertave dhe është konstatuar:

“Lidhur me planin dinamik të OE ankues” Mabco Constrction” paneli shqyrtues vlerëson se duke qenë se nuk ka legjislacion në fuqi në fushën e ndërtimit në Kosovë, dhe nuk është vërtuar mjaftueshëm se a është apo jo plani dinamik i ofruar nga OE në harmoni me dosjen e tenderit, paneli shqyrtues vlerëson se AK duhet të kërkojë gjatë rivlerësimit sqarime shtesë nga OE për planin e ofruar”.

Pra qeshtja e planit dinamik është trajtuar me vendim të organit kompetent, është potencuar se nuk ka legjislacion në fuqi në fushën e ndërtimit në Kosove, sa i përket planit dinamik dhe Autoriteti Kontraktues, duhet të kërkojë gjatë ri vlerëimit sqarime shtesë lidhur me planin dinamik. Ne si grup i OE-ve kemi ofruar sqarime konkrete lidhur me planin dinamik përdorisa juve si Autoritet Kontraktues, në njoftimin e datës 28.05.2025, ndaj ofertës sonë nuk kemi dhënë kurrefare arsyetimi të eliminimit.

Edhe në procesin paraprak të kontestimit të vendimit tuaj si Autoritet Kontraktues ne si kompani kemi sqaruar që me ligj për Prokurim Publik në fuqi dhe rregulla tjera të ndërtimit qëllimi i planit dinamik është përfundimi në afatit të përcaktuar të aktivitetit punës. Planin dinamik i prezantuar nga grupi i OE-ve, ankues në ofertë, ka të përshkruara të gjitha fazat e realizimit të punës dhe sipas afatit të përcaktuar nga AK – Ministria e Shëndetësisë.

Rrejdhimisht, mos aplikimi i formës së Autoriteti Kontraktues – MSH, nuk e bënë ofertën e pa përgjegjeshme, përkatësisht, paragrafi. 3 i nenit 44 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik, nuk është obliguese për kompanitë. Forma standarde ka për qëllim të ndihmojë kompanitë ofertuese vetëm për përgaditjen e ofertave.

Par. 3 i nenit 44 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik parasheh që:

“Qëllimi i dokumenteve standarde është që të ndihmohen Operatorët ekonomik gjatë përgatitjes së ofertave.”

Pra sipas dispozites se sipër pershkruar forma standarde ka për qëllim të ndihmoj operatorin ekonomik dhe nuk ka për qëllim të obligoj, që të përdor të njëjtën.

Sa i përket aplikimit të formës standarde lidhur me planin dinamik të realizimit të punëve, ekzistojnë edhe vendime të OSHP-së si dhe interpretime të KRPP-se. Madje lidhur me planin dinamik edhe juve si Autoritet Kontraktues – MSH, gjegjësisht zyrtarë përgjegjës të prokurimit si dhe anëtarë të njëjtë të komsinonit vlerësues apo ri vlerësues, për kompani tjera në procedura tjera keni gjykuar ndryshe, pavarësisht se kompanitë nuk kanë aplikuar format standarde, ju si AK i keni kualifikuar si të përgjegjshme.

- Shembull konkret për procedurën e prokurimit të inicuar nga ju si AK – MSH “Ndërtimi i QKMF Drenas”, me nr prok: 206-23-6378-5-1-2, pavarësisht kërkesës se AK-se, për plan dinamik të kërkuar me formë standarde si në këtë rast, kompania “AC Ing” shpk, është kualifikuar si kompani e përgjegjshme dhe për këtë ekzistojnë dëshmitë e ngarkuara në platëformën e-prokurimi!

Me ligj për prokurim Publik, parimi i konsistences, i pa anshmerise, gjegjësisht mos trajtimi i barabarte i Operatoreve Ekonomik, pavarësisht procedurave të prokurimit, mos respektimi i vendimit të OSHP-se dhe anulimi i aktiviteit të prokurimit në kundërshtim me nenin 62, të LPP-se, konsiderohen si shkelje të rënda të ligjit për Prokurim Publik.

Neni 97, i Rregullores me nr 001/2022, për PP, par.1, pika d), h) dhe k), përcaktojnë:

97.1 Shkelje të rënda konsiderohen:

k. Anulimi i aktiviteteve të prokurimit në kundërshtim me nenin 62 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Ne njoftimin e datës 28.05.2025, ju si AK nuk keni dhënë kurrefare arsyetimi të eliminimit ndaj ofertës sonë.

OSHP, paneli shqyrtues në këtë procedure të prokurimit nuk ka qene konsistent si rrjedhojë nuk ka gjykuar njëjtë ndaj pretendimeve ankimore dhe jo vetëm.

OSHP, jo vetëm në këtë procedure të prokurimit nuk ka qene konsistente.

- Procedurën e prokurimit me nr. indentifikimi 214-22-8829-5-1-1, me vendimin e datës.17.01.2023, dhe numër, 569-579/22, e ka anuluar, pastaj me vendimin e datës 25/07/2023, dhe numër OSHP: 2023/0074, e ka shfuqizuar vendimin e sajë për anulim dhe lenden e ka kthyer në ri vlerësim. Perberja e panelit të njëjtë. Ngjashëm ka vepruar edhe me procedurën e prokurimit me nr. UA 2016-24-2858-1-1-1, me vendimin e datës 28/08/2024,, me nr. OSHP: 2024/0537, kompani e caktuar është eliminuar si e pa përgjegjshme, perderisa me vendimin e datës 28.05.2025, e njëjta kompani e eliminuar për procedure të njëjtë është kualifikuar si e përgjegjshme dhe i është aprovuar ankesa në tërësi, sipas vendimit me nr. OSHP: 2025/0128.

Pretendimi ankimor 4:

Grupi i OE-ve ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues – Ministria e Shendetesise, sa i përket ofertave tjera te cilat kane ofertuar me çmim me te ulet se oferta e grupit te OE-ve ankues, përveç arsytimit te eliminimit te pershkrjuara ne leter standarde dhe ne raport te ri vlereimit te ofertave te njejtat oferta kane edhe mangesi tjera lidhur me kerkesat e kapacitetit ekonomik dhe financiar si dhe me kerkesat e kapacitetit teknik dhe profesional nga neni 68 dhe 69 i LPP-se dhe nuk janë raportuar te gjitha mangesite dhe atë lidhur me konfirmimet bankare, pervojen dhe kualifikimet e stafit kyq apo edhe projekteve paraprakisht te realizuara si dhe nuk janë prezantuar certifikime adekuat ndaj stafit tjetër mbeshettes.

Sa i përket ofertës se OE “Invest Doel & Hidro Projekt shpk, e njejtat oferte është ne tërësi e pa përgjegjeshme ne aspekt administrativ dhe financiar, ku oferta e tyre nuk posedon validitet te ofertës dhe se ndaj stafit kyq te prezantuar nuk janë prezantuar kontrata ashtu siç është kërkuar ne dosjen e tenderit, ku janë prezantuar kopje te vertetuara dhe se nuk janë prezantuar dokumente origjinale për noterizim, ku sipas arsytimit te eliminimit rezulton qe janë dorezuar shkresa dhe dokumente jo reale për te cilat juve si AK-MSH, perkateisht zyrtaret përgjegjës do duhej te ndermerrenit veprime tjera procedurale pasi qe neglizhenca dhe prolongimi i procedurës se prokurimit ne me shum se 1 vit ka patur dhe po vazhdon te këtë implikime financiare dhe ligjore ne shum aspekte.

Prandaj grupi i OE-ve ankues bazuar ne faktet, provat dhe dëshmitë e prezantuar me larte dhe atyre te bashkangjitura ne oferte, kërkojmë qe Autoriteti Kontraktues – Ministria e Shendetesise, zyra e Prokurimit te nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet,** si e bazuar ne tërësi kerkesa për ri shqyrtim,
- II. Anulohet,** njoftimi mbi vendimin e AK-se për anulim te procedurës, i datës 28.05.2025, si i kunderligjeshem dhe lënda te kthehet ne Rivleresim;
- III. Autorizohet,** komision profesional i pa anshem dhe oferta e grupit te OE-ve ankues te kualifikohet si e përgjegjeshme si oferta e veteme e përgjegjeshme dhe e cila posedon interes juridik ashtu siç percaktohet me nenin 4.1.26, te LPP-se.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Te konsiderueshme e qe do te kalkulohej pas perfundimit te procedurës.

Pretendimet ankimore sipas Grup i OE ADA & SHM Arch & Vllezerit Asllani:

- I. **Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve**, sipas nenit 59 të ligjit, ndërlidhur me nenin 40 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, lidhur me “Kërkesat mbi gjendjen ekonomik financiare” sipas nenit 68 të ligjit dhe nenit 8.1 dhe 8.2 të FTD-së.

Autoriteti kontraktues me date 28.05.2025 ka ngarkuar ne platformën e e-prokurimit “B58 Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues” për herë të dytë pas ri-vlerësimit të ofertave sipas vendimit të PSH të OSHP-se, së bashku me “Letrat Standarde për tenderuesin e eliminuar dhe Suksesshëm” ku ka anuluar aktivitetin e prokurimit në tërësi me arsyetimin se: *“në mungesë të ofertave të përgjegjshme, asnjë ofertë nuk plotëson të gjitha kërkesat e përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit”*.

Arsyet e eliminimit të grupit tone të operatorëve ekonomik sipas “Letrës Standarde për tenderuesin e eliminuar” është tërësisht e gabuar dhe keq aplikuar QELLIMISHT nga ana e autoritetit kontraktues kur njërin nga arsyet mundohet të konsideroj si ndryshim material, ndërsa arsyetimin tjetër, e përfshin në përfundimin e tërësisë së projektit, e jo të asaj që është kërkuar, *“....të jenë kryer punime lidhur me X-Ray*”

Andaj, konsiderojmë se “vlerësimet” e këtyre kërkesave janë nxjerrë me konstatim të gabuar dhe jo të drejtë të gjendjes faktike.

ARSYE 1. - *“Nuk e keni plotësuar Kërkesën 2 mbi mundësinë teknike dhe/pse profesionale-Pas shqyrtimi të dëshmive të ofruara nga QKUK është evidentuar se pranimi teknik final është realizuar pas dates së hapjes së ofertave 27.02.2024. Kjo dëshmon se nuk është plotësuar kritri për pranim teknik të projektit para afatit të fundit të dorezimit të ofertave dhe ky projekt është i pa pranueshem sipas kërkesave të NJK dhe DT. Bazuar në këtë fakt nuk mund të pranohen as dyert X-ray me hapje automatike si pjesë e këtij projekti”*.

Sipas kërkesës së përcaktuar tek, Seksioni II, “Fleta e të dhënave të tenderit”, gjegjësisht “Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale” të nenit 9.1 & 9.2, ceket:

Kërkesa 2:

“Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka realizuar me sukses projekte të ngjashme- ndërtim ose renovim i objekteve të larta, në vlerë të përgjithshme jo më pak se 25 Milion Euro, gjatë periudhës së shkuar tre vjeçare deri në Njoftimin për Kontratë. Në rast të konsorciumit, së paku 50% e punëve të përfunduara kërkohet për liderin e grupit.

Së së paku në njërin projekt të jenë kryer punime lidhur me X-ray, Gaz medicinal, ventilim, klimatizim, dyer Xray Automatike, etj.”

Dëshmi 2:

Një Listë të projekteve të realizuara - Original e vulosur dhe e nënshkruar.

Lista duhet t'i ketë këto të dhëna:

- Titulli i kontratës
- Investitori
- Të dhënat e personit kontaktues,
- Datën e fillimit dhe të përfundimit të projektit,
- Vlerën e projektit.

Konsiderohen të vlefshme vetëm listat me të dhënat e lartcekura.

Për çdo projekt të realizuar kërkohet Referencë ose Procesverbal i Pranimit teknik (për investitor privat AK mund t'i verifikoj transaksionet financiare).

FAKTET DHE ARGUMENTET, është fakt i patjetërsueshëm se autoriteti kontraktues qëllimisht ka "konstatuar PËRSERI gabimisht" gjendjen faktike lidhur me dëshmitë tona të dorëzuara me tender lidhur me realizimin E PUNIMEVE për dyer X-Ray edhe gjatë fazës së rivlerësimit.

Deklarojmë se: Ada Consulting Group SHPK, ka paraqitur PROVA të mjaftueshme për të vërtetuara se PUNIMET E REALIZUARA për X-Ray kanë përfunduar para datës së publikimit të njoftimit për kontratë.

Me dëshmitë e listura dhe bashkangjitura me këtë kërkesë për rishqyrtim do shpjegojmë dhe dëshmojmë të kundërtën e asaj që autoriteti kontraktues ose individë brenda autoritetit kontraktues mundohen të paraqesin.

01 Kontratën e lidhur mes OE ACG-së dhe AK QKUK_09.07.2019.

Kontratën si dëshmi po ngarkojmë për qëllime të shpjegimit dhe vërtetimit rreth mënyrës së trajtimit të çështjes së procedurave të pranimit të kontratave të punëve sipas nenit 33, e me specifikisht të paragrafit 33.3, shih më poshtë:

Neni 33 Pranimi i përkohshëm

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe të jetë lëshuar, ose konsiderohet të jetë lëshuar, një certifikatë e pranimit të përkohshëm.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit të Kontraktuesit, të jenë të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilit, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

Andaj, ndërlidhur me piken e mëposhtme 10. "Rekomandim për pranim teknik Përfundimtar - Ortopedia 29.11.2023)", vërtetohet se edhe TËRË PROJEKTI (jo vetëm PUNIMET për X-Ray) konsiderohet i pranuar më datën 27-30.12.2023 kur i referohemi datës së dorëzimit të "Kërkesës për Dorëzim të Projektit të datës 27.11.2023, pasi që neni 33 par 2 i Kontrates e përcakton në mënyrë taksative se AK ka qenë i obliguar që jo më larg se 30 ditë nga dita e rekomandimit të lëshojë certifikatë për pranim ose refuzim të rekomandimit, gjë që në rastin konkret nuk e ka lëshuar, e që në kuptim të nenit 33 të kontrates, hyn në funksion edhe dispozita e nenit 100 të LPPA-së, i cili përcakton se: "1. Nëse pala ka kërkuar nxjerrjen e një akti administrativ të shkruar dhe organi publik nuk e njofton palën për aktin administrativ brenda afatit fillestar dhe nuk njofton shtyrjen apo nuk njofton për aktin brenda afatit të shtyrë, sipas nenit 98 gjegjësisht 99 të këtij Ligji, kërkesa e bërë nga pala do të vlerësohet e pranuar në tërësi dhe akti administrativ i kërkuar nga pala do të vlerësohet të jetë miratuar (në vijim: "akti administrativ i miratuar në heshtje")."

02. Plani i menaxhimit të kontrates_25.08.2019.

Përgatitur nga Menaxherja e Projektit QKUK, ku palët ishin pajtuar si më poshtë, citoj:

1. Duke u bazuar në kërkesën e AK (përfituesit-Klinika e Ortopedisë) punimet do të behen fillimisht në Objektin e ri-Klinika e ortopedisë, i cili objekt do të përfundohet në tërësi do të behet pranimi teknik i objektit të ri-klinika e ortopedisë, bartja e stafit nga objekti ekzistues i sallove të operacioneve si dhe funksionalizimi në tërësi.

2. Pas pranimit teknik të pjesës së objektit të ri-Klinika e ortopedisë, do të fillojë rrenimi dhe punimi i objektit tjetër".

Pra kur autoriteti kontraktues ka konstatuar se, citoj: "... për këtë projekt mungon pranimi teknik", ka dështuar që të vlerësojë se puna në këtë projekt ka qenë e organizuar në DY faza nga vetë

autoriteti kontraktues, me qëllim të funksionimit të Objektit të Ri-Klinika e Ortopedisë, për çka ne si kontraktor edhe e kemi bërë të mundshëm bazuar në PMK e dt.25.08.2019, dhe pikërisht për këtë arsye është konsideruar edhe pranimi i pjesshëm i tërësisë së projektit (por PUNIMET për X-Ray KANË PËRFUNDUAR para datës së publikimit të njoftimit për kontrate ku në punët e kryera dhe të pranura hynë edhe pozicionet e kërkuara sipas FTD-së.

03 Pranimi teknik i fazës së parë Aneksi "J", dt.06.02.2023.

Ju lutem referohuni KONSTATIMIT të bërë në shkresën e datës 06.02.2023 me numër të protokollit Nr. 1071, "*Plotësim Ndryshim i Raportit për pranim të pjesshëm të Ndërtesës së Sallave të Operacionit (aneksi J) pjesë e kontratës së lartcekur*", që DESHMON se PUNIMET kanë përfunduar dhe janë të pranueshme.

KONSTATIM

Pas vizitave dhe takimeve në teren, shqyrtimit të dokumentacionit të lartpërmendur dhe raporteve të organit mbikqyrës, deklaratave të inxhinierëve dhe menaxhorit të kontratës kemi verifikuar punët e realizuara dhe ndryshimet. Së këndejmi konstatohet se punimet ndërtimore të kryera në ndërtesën e Bllokut Operativ - Aneksi (J) janë realizuar sipas specifikave të kontratës dhe në aspektin cilësor janë teknikisht dhe vizuelisht të pranueshme.

Për me tepër salla operative e Klinikës operative objekt i ndërtimit të kësaj kontrate është NE FUNKSION para datës së publikimit të këtij tenderi/aktiviteti të prokurimit dhe si i tillë është i pranuar dhe funksional, se përndryshe nuk mund të përdorej?! Pra tendenca që autoriteti kontraktues tenton ta ndërlidhë Objektin J me Objektin V nuk qëndron, pasi që edhe sipas PMK edhe sipas Raportit 06.02.2023 konstatohet në mënyrë taksative se dyert X-Ray janë të pranura dhe janë lëshuar në punë, pas pranimi teknik të tyre.

Shih me poshte kërkesën e ADA Consultin Group për pranim teknik, dhe rekomandimin e organit mbikqyrës ALB-ARCHITECT:

4. Rekomandimi i Organit mbikqyrës nga "Alb-Architect" të datës 05.07.2022
5. Kërkesa për pranim të pjesëshëm të objektit punëkryesi Ada Consulting Group Sh.P.K.

04 Minutatat e Takimit SHSKUK ORTOPEDIA 29.06.2022

Nga minutat e takimit të mbajtura mes palëve kontraktuese, mund të vëreni qartë se tashmë neve kishim hyrë në fazën përfundimtare të punimeve për këtë pjesë, që do shpinte tek konstatimi i shprehur me sipër nën pikën 03.

Konkluzion:

1. Të behen testimet e sistemeve dhe të dorëzohen para pranimit Teknik raportet e testimit.
2. Të behet Kërkesa zyrtare për pranim të pjesshëm për objektin A.

05 Rekomandim Pranimi Teknik i Punimeve të Kryera 05.07.2022

Nga shkresa e përgatitur nga kompania menxhuese dhe mbikëqyrëse e projektit "ALB ARCHITECT" e kontraktuar nga QKUK, i REKOMNADON zv. Menaxherit të Kontratës z. Bashkim Ibrahim, që QKUK të formoj komisionin për inspektim teknik të të punimeve të kryera për; bllokun operativ të Klinikës së Ortopedisë

Alb-Architect si menaxhues i projektit dhe mbikëqyrjes i REKOMANDON Qendres Klinike Universitare të Kosovës si Autoritet Kontraktues që të formoj komisionin për inspektim teknik të përsëritshëm të punimeve të kryera në projektin "Mbledhja dhe zgjerimi i objektit ekzistues të bllokut operativ të Klinikës së Ortopedisë"

Kjo dëshmon se punimet në bllokun e sallës operative të Klinikës së Ortopedisë kanë përfunduar dhe janë të gatshme për pranim.

06 Raporti javor i fotove Ortopedia 05.07.2022

Ky raport në formatin Excel është ngarkuar për qëllim që më mënyrë vizuale të kuptoni dhe të dëshmohet se punimet në bllokun e sallës operative të Klinikës së Ortopedisë ishin afër përfundimit. Këto foto pasojnë minutat e takimit në pikën 04 dhe ndërlidhen me raportin e përshkruar nën pikën 05

07 Rekomandimi i Pranimit Teknik xRay 06.07.2022

Nga shkresa e përgatitur nga kompania menxhuese dhe mbikëqyrëse e projektit "ALB ARCHITECT" e kontraktuar nga QKUK, i REKOMNADON zv. Menaxheri i Kontratës z. Bashkim Ibrahim, që QKUK, duhet të paiset me certifikatën për mbrojtjen nga rrezet X, për sallat e operacionit nga Autoriteti Përgjegjës për këtë lloj të aktivitetit.

Alb-Architect si menaxhues i projektit dhe mbikëqyrjes i REKOMANDON Qendres Klinike Universitare të Kosovës si Autoritet Kontraktues që duhet të paiset me certifikatën për mbrojtje nga rrezet -X për sallat e operacionit nga Autoriteti Përgjegjës për këtë lloj të aktivitetit.

Kjo dëshmon se punimet në bllokun e sallës operative të Klinikës së ortopedisë kanë përfunduar TASHMË, dhe se autoriteti kontraktues, QKUK duhet të aplikoj për certifikim tek autoriteti përkatës shtetëror.

08 Minuatat e Takimit SHSKUK Ortopedia 07.12.2022

Nga minutat e takimit të mbajtura mes palëve kontraktuese, mund të vëreni qartë se tashmë se kjo pjesë ishte në funksion dhe ishte nën garancion. Kjo dëshmon shumë qartë se punimet kanë përfunduar kohë më parë.

2	Diskutime të përgjithshme në lidhje me funksionimin e pjesës së objektit që tashmë është në funksion si dhe për ecurine e punimeve në demollimin e pjesës së vjetër.
---	--

09 Rregullimi i dyerve pas Pranimit 07.03.2023

Duke j'u referuar pikës 08 më sipër dhe diskutimeve të përfshira aty, shihet se nga kontraktori kërkohet të ndërhyhet në rregullimin e dyerve automatike për shkak të telasheve në funksionim. Me datën 07.03.2023 kontraktori ADA, njofton QKUK-në për hapat e ndërmarr si dhe arsyet që po vije deri tek mos funksionimi i dyerve, nga keq operimi i stafit të QKUK-së.

Kjo përsëri dëshmon se pranimi teknik i këtyre punimeve ka përfunduar moti dhe ka qene në funksion dhe nën periudhë garantuese, për qka OE Ada Consulting Group në kuader të garancionit ka ndërhyrë në rregullimin e tyre pasi që për shkak të përdorimit jo adekuat (përdorimi i hapjes me forcë fizike) nga stafi i QKUK-Ortopedi, ato kishin dale nga sistemi i funksionit.

10 Kërkesa për pranim teknik përfundimtar nga Ada Consulting Group 27.11.2023

Nga kjo kërkesë shihet qartazi se Ada Consultin Group SHPK, kishte dorëzuar kërkesen për pranim përfundimtar teknik të projekti në teresi, pasi që kishte përfunduar të gjitha punimet sipas projektit "Mbindertimmi dhe zgjerimi i objektit ...", duke kërkuar edhe caktimin e datës për inspektim final dhe dorëzimin e dokumentacionit të kompletuar për pranim teknik.

11 Rekomandim për pranim teknik Përfundimtar - Ortopedia 29.11.2023

Duke u nisur nga përshkrimi i këtij raporti mund të konstatohet se organi menaxhues dhe mbikqyres ALB_ARCHITEC, i kontraktuar nga QKUK, ben rekomandimin e pranimit teknik të punëve, dhe kjo vije pas kërkeses së datës 27.11.2023 bërë nga punëkryesi ADA Consulting Group.

Kjo është edhe një dëshmi shtesë që ndërlidhet me faktin se punimet kanë përfunduar para datës që autoriteti kontraktues pretendon e që është data 31.05.2024, datë kur është portokoluar raporti. Por ligjerisht projekti është pranuar më datën 27-30.12.2023.

12 Raporti Përfundimtar i Menaxheres së Kontratës, dt.29.11.2023

Me datë 29.11.2023 Menagjerja e Kontratës, znj.Donjeta Berisha, harton Raportin Përfundimtar të cilin ja drejton z. Nexhat Halili, Shef i Prokurimit në QKUK, i cili protokollohet me nr.343 dt.16.01.2024, dhe me të cilin e njofton me gjithë ecurinë e procesit të punimeve dhe kryejn e të gjitha punëve nga operatori ekonomik në pajtim me paramasat dhe parallogarite të skiceave të projektit sipas kontratës së nënshkruar.

13 Pranimi Teknik i fazes së dytë Aneksi "V", dt.31.05.2024

Duke u nisur nga leximi i këtij raporti, sidomos pikave 4 dhe 5 si më poshtë, dhe nesë i referohemi nenit 33.3 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës KOSTATOHET se i tërë projekti është pranuar më datën 27-30.12.2023

- | |
|--|
| 4. Rekomandimi i Operatorit mbikqyrës nga "Alb-Architect" për pranim teknik përfundimtar të datës 29/11/2023 |
| 5. Kërkesa për pranim teknik (email) (date: 27.11.2023) punëkryesi Ada Consulting Group Sh.P.K. |

14 "Situacionit 3"

Nese shikohet me kujdes "Raporti për kontroll teknike të pjesës së dytë të ndërtesës së sallave të operacionit (Aneksi V) pjesë e kontratës së lartcekur" i dt. 31.05.2024, shihet qartazi se nuk kemi të bëjmë me pranim përfundimtar të projektit ashtu sic konstaton Komisioni i Vlerësimit me rasiin e dërgimit të Letrës Standarde-B42, por e vërteta qëndron në faktin se kemi të bëjmë me pranim të Objektit "V", i cili në bazë të PMK është objekt i ndarë nga "Objekti J" në të cilin janë të vendosura dyert X-Ray.

Ajo që pasqyrohet në Raportin e dt.31.05.2024, është fakti se kemi të bëjmë me pranim të punëve të kryera që nuk përkojnë fare me pozicionet e "Situacionit 3" të pranuar sipas "Raportit për kontroll teknike të pjesës së parë të ndërtesës së sallave të operacionit (Aneksi J) pjesë e kontratës së lartcekur" i dt.06.02.2023 (ku ishin pranuar dyert X-ray) pasi që sic e theksuam Objekti "V" ka qenë i ndarë me PMK, dhe pranimi i tij është bërë jo si pranim i tërësishëm dhe përfundimtar sic konstaton AK, por si pranim i pjesës së dytë të ndërtesës.

KONSTATIM

Pas vizitave dhe takimeve në teren, shqyrtimit të dokumentacionit të lartpërmendur dhe raporteve të Operatorit mbikqyrës, deklaratave të inxhinierëve dhe menaxherit të kontratës kemi verifikuar punët e realizuara dhe ndryshimet. Së këndejmi konstatojmë se punimet ndërtimore të kryera në ndërtesën e Aneksi (V), objekti mund të përdoret për shfrytëzim. Komisioni rekomandon të vazhdohet me procedurat e mëtejshme.

Andaj edhe të gjitha këto përshkrime, në mënyrë të qartë dhe shumë të argumentuar hedhin poshtë "argumentin" e Komisionit të Vlerësimit, se punimet kanë përfunduar pas datës së publikimit të njoftimit për kontratë (përderisa në "Letrat standarde.." jeni shprehur gabimisht "deri në datën e mbylljes..")

15 Kërkesa e ADA Consulting Group dërguar Stafit Menaxhues dhe Mbikqyrës të Kontratës

Duke parë se autoriteti kontraktues në mënyrë të vazhdueshme insiton në një qëndrim të pa baze se punimet nuk kanë përfunduar, neve si grup i operatorëve ekonomik jemi detyruar që për hirë të

saktesise te kerkojme nga QKUK, gjegjesisht ekipi menaxhues i kontrates/projektit te konfirmojne me data perfundimin e punimeve te pershkruar ne kete kerkese. Shih kerkesen derguar QKUK, ekuip menaxhues te projektit/kontrates.

16 Pergjigjja e konfirmimit nga Menaxherja e Kontrates

Ne pergjigje te saj permes e-mailit menaxheria e kontates KONFIRMON te gjitha ato qe neve kemi dorezuar me oferte, me sqarimet dhe deshmitet e dorezuara me kete kerkese per rishqyrtim. Andaj besojme fuqishem se tani si autortiet kontraktues nuk keni asnje hezitim se punimet kane perfunduar shume kohe me pare. Shih e-mailin e derguar si dhe shkresen e bashkngjitur.

ARGUMENTE SHITESË TË PATJETËRSUESHME

- Vet konstatimi si pjesërisht i bazuar nga ekspertet shqyrtues, citati: *"Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar"*, dëshmon se pretendimi qëndron, por nuk kanë krejtësisht të qartë brengen e autoritetit kontraktues!?
- Juve si autoritet kontraktues por edhe zyrtar përgjegjës e konfirmoni se punimet që ka të bëjë me sallën operative të Klinikës së Ortopedisë, Faza e Parë, se këto PUNIME kanë përfunduar. Kjo është e cekur në e-mail për sqarime dërguar tek QKUK ku shpreheni:

"Sipas dëshmiave shihet se projekti është i ndarë në dy pjesë dhe është pranuar vetëm Pjesa e parë"

- Per qartesi dhe kuptim me te qarte te termeve te perdorura nga autoriteti kontraktues ne dosje te tenderin, specifikisht tek "Kerkesat Teknike Profesionale", sic eshte termi i perdorur "Procesverbal i Pranimit teknik" dhe termi "Pranimi i Perkohshem" sipas nenit 33 te Kushte te Pergjithshme te Kontrates, neve e shohim te domosdoshme te japim sqarimin e nevojshem te dallimit kuptimor mes ketyre dy termave:

Në kontekstin e kontratave të punës, "Pranimi teknik" dhe "Pranimi i përkohshëm" janë dy faza të dallueshme në procesin e pranimi të projektit:

- **Pranimi teknik:**

Kjo fazë përfshin inspektimin dhe testimin e materialeve dhe të punës për t'u siguruar që ato të përmbushin standardet dhe kërkesat teknike të përcaktuara në kontratë. Është një hap paraprak ku fokusi është në verifikimin e aspekteve teknike të punës, të tilla si cilësia, siguria dhe respektimi i specifikimeve teknike.

- **Pranimi i përkohshëm:**

saktesise te kerkojme nga QKUK, gjegjesisht ekipi menaxhues i kontrates/projektit te konfirmojne me data perfundimin e punimeve te pershkruar ne kete kerkese. Shih kerkesen derguar QKUK, ekuipmenat te projektit/kontrates.

16 Pergjigjja e konfirmimit nga Menaxherja e Kontrates

Ne pergjigje te saj permes e-mailit menaxheria e kontates KONFIRMON te gjitha ato qe neve kemi dorezuar me oferte, me sqarimet dhe deshlime te dorezuara me kete kerkese per rishqyrtim. Andaj besojme fuqishem se tani si autortiet kontraktues nuk keni asnje hezitim se punimet kane perfunduar shume kohe me pare. Shih e-mailin e derguar si dhe shkresen e bashkngjitur.

ARGUMENTE SHITESË TË PATJETËRSUESHME

- Vet konstatimi si pjesërisht i bazuar nga ekspertet shqyrtues, citati: *"Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar"*, dëshmon se pretendimi qëndron, por nuk kanë krejtësisht të qartë brengjen e autoritetit kontraktues!?
- Juve si autoritet kontraktues por edhe zyrtar përgjegjës e konfirmoni se punimet që ka të bëjë me sallën operative të Klinikës së Ortopedisë, Faza e Parë, se këto PUNIME kanë përfunduar. Kjo është e cekur në e-mail për sqarime dërguar tek QKUK ku shpreheni:

"Sipas dëshmnive shihet se projekti është i ndarë në dy pjesë dhe është pranuar vetëm Pjesa e parë"

- Për qartësi dhe kuptim me të qartë të termave të përdorura nga autoriteti kontraktues në dosje të tenderin, specifikisht tek "Kërkesat Teknike Profesionale", sic është termi i përdorur *"Procesverbal i Pranimit teknik"* dhe termi *"Pranimi i Përkohshëm"* sipas nenit 33 të Kushtesës së Përgjithshme të Kontrates, neve e shohim të domosdoshme të japim sqarimin e nevojshëm të dallimit kuptimor mes këtyre dy termave:

Në kontekstin e kontratave të punës, "Pranimi teknik" dhe "Pranimi i përkohshëm" janë dy faza të dallueshme në procesin e pranimit të projektit:

- **Pranimi teknik:**

Kjo fazë përfshin inspektimin dhe testimin e materialeve dhe të punës për t'u siguruar që ato të përmbushin standardet dhe kërkesat teknike të përcaktuara në kontratë. Është një hap paraprak ku fokusi është në verifikimin e aspekteve teknike të punës, të tilla si cilësia, siguria dhe respektimi i specifikimeve teknike.

- **Pranimi i përkohshëm:**

8. Dëmet materiale

Shkeljet e mësipërme pritet të shkaktojnë dëm material të fitimit të humbur dhe të cilat dëme do të precizohen pas mendimit dhe konstatimit të ekspertit financiar.

Pretendimet ankimore sipas BM Group SH.P.K.:

Ankesa / Kërkesa për rishqyrtim është e ndarë në 2 Pjesë:

Pjesa 1. Plotësimi / Shtjellimi i dokumentacionit për eliminimin tonë OE

Pjesa 2. Anulimi i aktivitetit

PJESA 1.

Autoriteti Kontraktues: me publikimin e Njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ka bërë shkelje të: Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, ku i njehti ka paraqitur në këtë njoftim dokumentacione të cilat nuk janë reale, të cilat mund të kërkojnë me nenin 72 të Ligjit të Prokurimit Publik, ku Autoriteti me respektimin e këtij neni: Neni 72. Dokumentacioni dhe informacioni shtesë i cili thekson qartë: 1. Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

4. Në procedurat që shpien në dhënien e kontratës publike në të cilën përfshihet sigurimi i shërbimeve, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë të dhënat me të cilat dëshmohet aftësia e tyre për sigurimin e këtyre shërbimeve; në veçanti, të dhënat mund të kërkojnë lidhur me shkathësitë, efikasitetin, kapacitetin, përvojën dhe besueshmërinë. Të dhënat përkitazi me aftësitë teknike të operatorëve ekonomik mund të parashtrohen përmes një ose më shumë mjeteve në vijim, sipas llojit, sasisë dhe qëllimit të shërbimeve që duhet të furnizohen: 4.2. listën me të cilën saktësohen të gjitha kontratat kryesore të rëndësishme të shërbimeve të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, duke saktësuar llojin e shërbimeve të përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin; (i) kur shërbimet janë siguruar për autoritetin publik në Kosovë ose në vendin tjetër, si dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve do të shërbejë kopja e certifikatës (certifikatave) përkatëse të lëshuar ose bashkënenëshkuara nga autoriteti i tillë publik; (ii) kur shërbimet janë siguruar për blerësin privat, dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve duhet të jetë kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i sigurimit të tillë;

Lidhur me arsyen e eliminimit.

Kompania [BM GROUP SHPK] e ka plotësuar në përpikëri kushtin për të cilin jemi eliminuar. Në dosje të tenderit është kërkuar që si punë të kryera të jenë mbi 25 milion euro vlerë e punëve në si kompani për tri vitet e fundit kemi derkuar listën e punëve të kryera .

Sipas VENDIMIT te AK :

OE BM Group S.H.P.K me sqarime shtese ka ofruar edhe Listën e punëve të kryera me kontrata dhe referenca. Komisioni i ri-vlerësimit pas shqyrtimit të tyre konsideron se nga lista e kontratave të realizuara nuk e plotëson këtë kriter pasi që nuk ka kontrata për punë të realizuara në vlerë prej 25,000,000.00 € me dëshmitë siç janë kërkuar.

Si komision i ri-vlerësimit i konfirmojmë konstatimet e dhëna në vendimin e OSHP-se: OE i rekomanduar në listë të projekteve të realizuara ka paraqitur 25 projekte, ndërsa tek referencat ka 23 sosh, meqë në 2 (dy) prej tyre ka aneksë kontrata. Gjatë elaborimit të tyre është vërejtur: 2 (dy) Referenca (Demolation and Landscaping Central Vaccine dhe Ndërtimi i Fakultetit Ekonomik dhe FSHMN-së) nuk kanë nënshkrim, prej tyre njëra (1) nuk ka çmim të përshkruar (Demolation and Landscaping Central Vaccine) dhe tjetra është realizuar deri në masën 85% (Ndërtimi i Fakultetit Ekonomik dhe FSHMN-së); 1 (një) tjetër është në proces e sipër (Punimet në Parkun Industrial në Drenas); 1 (një) është vetëm furnizim (Furnizimi për ndërtimin e objektit afërsto-banesor të investitorit Pozhegu Brothers). Lidhur me projektet: Ndërtimi i Stadionit të qytetit në Gjiilan, Faza e parë - Renovimi i stadiumit në Gjakovë, Faza e dytë - Ndërtimi i stadiumit të qytetit Drenas, Ndërtimi i Parkut Industrial në Miradi, ndërtimi i Fakultetit të FSHMN-së - Prishtinë, Ndërtimi i stadiumeve ndihmëse në Gjiilan, Pejë, Drenas dhe Studençan, Furnizimi dhe ekzekutimi i punëve në parkingut në Prishtinë, Ndërtimi dhe furnizimi i ndërtimit në Lagjen Matigona Hill, Furnizimi me beton për ndërtimin e objekteve afërsto-banesore për Pozhegu Brothers. Për të gjitha këto projekte OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar kontrata dhe referenca, të cilat nuk dëshmojnë realizimin/përfundimin e suksesshëm të këtyre projekteve. Përkundrazi në këto referenca shënon "Referencë pozitive ... prej fillimit të kontratë deri në sot...", "realizim i punimeve deri në masën 85%", "... në punimet që po zhvillohen ...", "... me sukses e ka përfunduar pjesërisht furnizimin ...", e të ngjashme. Duke u bazuar në këto konstatime, në të cilat vërtetohet se OE i kontraktuar nuk ka përfunduar në tërësi punët sipas marrëveshjes kontraktuale, pastaj kontrata me vetëm furnizim, si dhe kontrata të kombinuara furnizim dhe punë, rezulton që OE i rekomanduar nuk e arrin shumën e kërkuar me dosje të tenderin në vlerën prej 25,000,000.00 euro. Në lidhje me detyrë X-Ray hapje automatike, OE i rekomanduar nga AK e posedon dhe e vërteton me Kontratën e lidhur me UNOPS për Rehabilitimin e Klinikës së Radiologjisë në Ferizaj, konkretisht në kapitullin Annex A - Bill of Quantity (Bill 2). Bazuar në gjitha këto që u cekën më lart OE BM Group S.H.P.K nuk plotëson kërkesën për punë të ngjashme në vlerë 25,000,000€.

Nëse hesoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesin për nisat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,

Berat Marmullaku
(Emri dhe Mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit)


(Nënshkrimi)

Sipas nent 69 asnjere nuk eshte e cekur se kontratat duhet te jene plotesisht te perfunduara qe te kete qertifikaten e puneve te kryera apo referencen. Saktesisht eshte thene qe OE duhet te kete Referencen per punet e kryera qka do te thot per punet qe ka perfunduar deri ne at

moment te kete nje pranim teknik apo reference qe AK apo investori per te cilin ka kryer pune , ato pune te jene te pranuar teknikesht.Sipas ketij neni ne si OE kemi plotesuar me sakesi kontraten pasi qe me sqarim e kerkuar nga AK kemi ofruar edhe deshmit qarkullimet bankare me investoret privat. Kjo do thote qe qdo pune e perfunduar per te cilin kemi reference dhe qarkullime bankare duhet te pranohet pa marre parasysh se asht e perfunduar marrevshja komplet.

Poashtu po ju dergoj edhe nje here sqarimet e kerkuara nga vet ju te dates 30.10.2024 ne te cilen jane te te cekura detajisht titulli i kontrates, vlera e kontrates si dhe qarkullimet bankare per secilin investor sidomos ata private.

Ne mendojmë poashtu pasiqe ne kemi ofruar sqarime te njafgueshme ne kerkesen tuaj per kete pike nuk ka qene e drejte te anulohemi per arsyetimin e njejte.

Ne baze te ketij neni neve si OE na eshte bere e pa drejte anulimi nga kjo gare pasi jemi OE me i denje dhe me i kompletuar si dhe me qmimin me te favorshem per fitimin e ketij aktiviteti te prokurimit.

Poashtu ne raportin e vleresimit te fundit ju si AK nuk e keni marrur fare per baze vendimin e OSHP-se ne raport me oferten tone dhe na keni eliminuar pa e elaboruar fare si oferte. OSHP ne vendimin e saj ka cekur sakesisht te merret edhe te rishikohet dosja edhe nje here dhe te analizohet oferta jonë.



REPUBLIKA E KOSOVES
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATOVANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Ekipa Shqyrtuese Harko e Epublika, Kati N°10, Prishtine, Kosova
Tel: 06 39 312 309 email: info@shqyrtuesi.net



OSHP: 2024/1186

OSHP: 2024/1191

OSHP: 2024/1200

OSHP: 2024/1202

OSHP: 2024/1232

Panelli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetaria e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përberjen nga Batisha Ibrahim Kryesuesi, Isa Hasani dhe Vedat Poterqaj/Andar të Panelit Shqyrtues duke vendosur sipas ankesës së OE "AK Invest Dessel Tehova & Hidro Project SH.P.K.", OE "JAM & Ra.H.P.", OE "Mabeo Construction SH.P.K. & AAG Projekt&Ink- Industria Metalike e Kosoves SH.P.K.", ankesës së OE "Ada Consulting Group SH.P.K." si dhe ankesës së OE "IM Group" kundër HSNjoftim mbi vendimin e AK-se lidhur me aktivitetin e prokurimit "Vazhdim i Ndërtimit – Qendra e Mjekësisë Emergjente në QUK" me nr. të prokurimit: "206-23-14371-5-1-1", iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Shëndetësisë, më 02.04.2025, mori këtë:

Vendim

1.Aprovohen, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE "Ada Consulting Group SH.P.K." me numër protokoll 2024/1186 e datës 09.12.2024, ankesa e OE "Mabeo Construction SH.P.K. & AAG Projekt & Ink- Industria Metalike e Kosoves SH.P.K." me numër protokoll 2024/1200 e datës 11.12.2024, si dhe ankesa e OE "IM Group" me numër protokoll 2024/1232 e datës 18.12.2024, të paraqitura për aktivitetin e prokurimit "Vazhdim i Ndërtimit – Qendra e Mjekësisë Emergjente në QUK" me numër të prokurimit 206-23-14371-5-1-1.

Vendimi i OSHP me date 02.04.2025 per aprovim te ankeses sone te dates 18.12.2024

Procedura e bupar

Cont. 32-61283 p. 524-534. Report 1. (13) March 1965. 20 p. 2015-2019

Not indicated

20101016374-5 0-0

Table 1 "Synthesis and Purification of Glycyl-L-Alanine and Glycyl-L-Proline by OXUN"

LAURENCE J. HARRIS, M.D., M.P.H., is a professor of epidemiology and population science at the University of California, San Francisco, and a senior advisor at the Centers for Disease Control and Prevention.

These results are consistent with the hypothesis that the presence of a social partner during the initial phase of the task reduces the cognitive load on the individual, thereby allowing for a more efficient allocation of resources to the task. This is particularly evident in the case of the 'No Partner' condition, where the lack of a social partner likely led to a higher cognitive load and a corresponding increase in error rates.

Michigan's former gubernatorial candidate, Gov. George Romney, is expected to announce his support for the measure.

Journal of

Question	Answer	Correct	Wrong	Score	Time	Used
1. Which of the following is a type of renewable energy source?	Solar energy	Yes	No	1	00:01:15	00:01:15
2. What is the primary function of a cell membrane?	To regulate the movement of substances in and out of the cell	Yes	No	1	00:01:30	00:01:30
3. Which planet is known as the 'Red Planet'?	Mars	Yes	No	1	00:01:45	00:01:45
4. What is the chemical formula for water?	H ₂ O	Yes	No	1	00:02:00	00:02:00
5. Which of the following is a type of non-renewable energy source?	Fossil fuels	Yes	No	1	00:02:15	00:02:15
6. What is the primary function of a chloroplast?	To perform photosynthesis	Yes	No	1	00:02:30	00:02:30
7. Which planet is the largest in our solar system?	Jupiter	Yes	No	1	00:02:45	00:02:45
8. What is the chemical formula for carbon dioxide?	CO ₂	Yes	No	1	00:03:00	00:03:00
9. Which of the following is a type of renewable energy source?	Wind energy	Yes	No	1	00:03:15	00:03:15
10. What is the primary function of a nucleus in a cell?	To store genetic material	Yes	No	1	00:03:30	00:03:30

35

Raporti i juve si AK ku nuk e keni marr as mundit qe te analizoni perseri oferten sipas vendimin e OSHP te dates 02.04.2025, ku ka cekur se duhet ta rishqyrtoni dhe ta analizoni oferten tone .

Poashtu ne ju bashkangjesim edhe vendimin e OSHP-s per nje AK –tjeter ne te cilen kemi marre pjese ne ofertim per nje projekt sikurse ky, ku per projektet e njejta –lista e projekteve e ofruar nga ne ne nje Autoritet tjeter , e ka marre per baze qdo projekt te mireqene dhe pas kerkesave per sqarime ka konstatuar se qdo projekt pune e ofruar nga ne si pune e perfunduar deri ne ate date eshte valide dhe sipas ligjeve te prokurimit merren parasyshe pasi qe ne si OE kemi ofruar per qdo projekt, fatura, transaksione, situacione, librin e shitjes ndemjet investitorit dhe punëkryesit.

Ne ankesën e njerit nga OE që ka ofertuar ka marrë shembull të gjitha projektet që kemi ofertuar në projektin e "Vazhdimi i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente në QKUK" dhe OSHP ka marrë vendim që qdo projekt është meritues dhe ka lënë në fuqi vendimin e AK.

OSHP: 2025/0213

OSHP: 2025/0214

Paneli Shqyrtues, i emëruar në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Isa Hasani-kryetar, Batisha Ibrahim dhe Kimete Gashi-anëtare, duke vendosur sipas ankesës së OE "Raf II" SHPK si dhe OE "CONEX L.L.C.", kundër Vendimit për dhënie të një kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit "Punë ndërtimore për zbatimin e projektit të hollësishëm [zbatues kryesor] të rregullimit hapësinor, të arkitekturës dhe inxhinierisë, për rindërtimin dhe përshtatjen [ri-konfigurimin] e Stadiumit në Gjilan, në përputhje me Kategorinë IV të rregulloreve dhe udhëzimeve teknike për infrastrukturë të stadioneve, të miratuara nga UEFA," me numër të prokurimit: 207-24-8996-5-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, më 12/05/2025, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet si e pabazuar, ankesa e OE "Raf II" SHPK, me nr. 2025/0213, e dates, 01/04/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Punë ndërtimore për zbatimin e projektit të hollësishëm [zbatues kryesor] të rregullimit hapësinor, të arkitekturës dhe inxhinierisë, për rindërtimin dhe përshtatjen [ri-konfigurimin] e Stadiumit në Gjilan, në përputhje me Kategorinë IV të rregulloreve dhe udhëzimeve teknike për infrastrukturë të stadioneve, të miratuara nga UEFA", me numër të prokurimit: 207-24-8996-5-1-1, AK-Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
2. Aprovohet si pjesërisht e bazuar ankesa e OE "Conex" L.L.C, me nr. 2025/0214, e dates, 01/04/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Punë ndërtimore për zbatimin e projektit të hollësishëm [zbatues kryesor] të rregullimit hapësinor, të arkitekturës dhe inxhinierisë, për rindërtimin dhe përshtatjen [ri-konfigurimin] e Stadiumit në Gjilan, në përputhje me Kategorinë IV të rregulloreve dhe udhëzimeve teknike për infrastrukturë të stadioneve, të miratuara nga UEFA", me numër të prokurimit: 207-24-8996-5-1-1, AK- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
3. Mbetet në fuqi, B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i datës 13.03.2025, për aktivitetin e prokurimit me numer: 207-24-8996-5-1-1, me të dhënat si në pikën një (1) të vendimit.

Ky është vendimi nga OSHP që ankesën e OE e merr si të pa bazuar pasi që ankesa e tij ndaj neve si OE të përgjegjshëm nuk ka qenë fare e arsyeshme dhe ka qenë pa bazë.

>Më poshtë po i kontestojmë kontratat dhe referencat e OE të rekomanduar për kontratë, e të cilët dokumente ne i kemi pranuar me qasje në tenderin me titull "Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente në QKUK" MINISTRIA E SHËNDETËSISË. Mendojmë se të gjitha këto kontrata janë të bashkangjitura edhe në këtë projekt.

>Referenca e lëshuar nga Bau Holding L.L.C në vlerë prej 1,435,818.68 €, e ku shënohet se ka përfunduar pjesërisht ndërtimin e stadionit të Gjilanit.

Kjo referencë është dashur të verifikohet se a janë kryer punë të ndërtimit apo janë bërë vetëm furnizime me beton apo diçka tjetër. Verifikimi është dashur të bëhet edhe përmes transaksioneve bankare.

>Referencë nga Parking Center në vlerë prej 1,313,564.01 €, e ku shënohet se kanë nënshkruar kontratë për ekzekutimin e punimeve (furnizim dhe punë).

Kjo referencë është dashur të verifikohet se a janë kryer punë të ndërtimit apo janë bërë vetëm furnizime me beton apo diçka tjetër. Verifikimi është dashur të bëhet edhe përmes transaksioneve bankare.

>Referencë nga Pozhegu Brothers në vlerë prej 535,694.00 €, e ku shënohet se me sukses pjesërisht ka përfunduar furnizimin me beton për ndërtimin e objektit afarist banesor Garden Building-C5 dhe Sofali.

Kjo referencë nuk është sipas kërkesës së dosjes së tenderit, sepse ka të bëjë me furnizime. Kjo vërtetohet edhe tek kontrata e prezantuar ndërmjet tyre.

>Referencë nga Ip Kos SHPK në vlerë prej 624,107.21 €, e ku shënohet se ka përfunduar furnizimin me beton dhe punimin e pompës.

Kjo referencë nuk është sipas kërkesës së dosjes së tenderit, sepse ka të bëjë me furnizime.

>Referencë nga Britania Homes SHPK në vlerë prej 922,353.22 €, e ku shënohet se ka përfunduar me sukses furnizimin dhe për ndërtimin e objekteve në lagjen Britania Homes.

Kjo referencë nuk është sipas kërkesës së dosjes së tenderit sepse ka të bëjë me furnizime.

>Referencë nga Marigona Hill SHPK në vlerë prej 838,593.00 €, e ku shënohet se ka përfunduar me sukses furnizimin dhe për ndërtimin e objekteve në lagjen Britania Homes.

Kjo referencë nuk është sipas kërkesës së dosjes së tenderit, sepse ka të bëjë me furnizime

Ankesa e OE-ankues ndaj projekteve tona te prezanuara ne dosje tenderi ne oferte –qe jane projektet e njejta sikurse ne ofertën per Vazhdimin e Objektit te Emergjences ne QKUK

➤Referencë nga Mada Group SHPK në vlerë prej 4,364,743.74 €, e ku shënohet se ka përfunduar me sukses furnizimin dhe për ndërtimin e objekteve në lagjen MARIGONA Hill.

Kjo referencë nuk është sipas kërkesës së dosjes së tenderit, sepse ka të bëjë me furnizime.

➤Referencë nga Bau Holding LLC në vlerë prej 6,268,653.31 € për punime në parkun industrial, mirëpo kjo kontratë duhet të verifikohet se a është realizuar për ndërtim të lartë dhe kjo duhet të bëhet duke analizuar transaksionet se a janë bërë pagesat dhe nëse ka pagesa, a janë bërë për ndërtim të lartë apo për furnizime. Kontrata e nënshkruar eket se ka të bëjë me furnizimin dhe kryerjen e punimeve.

Kjo referencë nuk duhet të merret parasysh.

➤Referencë nga R&Rukolli SHPK në vlerë prej 637,475.00 €, e ku shënohet se ka përfunduar punë si: instalime elektrike dhe nxemje qendrore.

Kjo referencë nuk është sipas kërkesës së dosjes sepse ka të bëjë me punë elektrike, kjo vërtetohet edhe nga kontrata e prezantuar.

➤Referencë nga Viva Fresh Store në vlerë prej 1,044,995.15 €, e ku nuk përputhet përshkrimi i bërë tek referenca me atë tek kontrata, sepse në kontratë titulli është kontratë për furnizim dhe shërbime.

Te gjitha ankesat ndaj referencave tona, ku OE-ankues ka bere ankese ndaj projekteve tona te paraqitura ne oferte sikurse tek oferta e projektit për Vazhdimin e Objektit te Emergjences ne QKUK.

Autoriteti Kontraktues nuk i ka pranuar referencat e pjesshme, nuk e ka pranuar referencën nga Pozhegu e cila ishte furnizim me beton, mirëpo referencat nga Bau Holding, Park Plaza, Britania Homes, Marigona Hill, Mada Group SHPK, Viva Fresh dhe R&Rukolli SHPK te gjitha janë referenca sipas natyrës se ngjashme, realizim i punëve te cilat lidhen direkt me natyrën e projektit, dhe se OE i ka dëshmuar me gjithë dokumentacionin sipas kërkesës se Autoritetit

Kontraktues (kur referencat janë nga sektori privat ato duhet te dëshmohen me fatura dhe transaksione bankare) mirëpo

OE përpos qe i ka vërtetur me këto 2 karakteristika i njëjti e ka dërguar edhe librin e shitjes gje qe vërteton edhe me shume aspektin e referencave.

Shënim me rendësi:

Komisioni vlerësues sipas kompetencave qe kishte, duke u bazuar në Ligjin e Prokurimit, konkretisht ne nenin 59 dhe 72 të Ligji të Prokurimit të Kosovës dhe sipas nenit 69 pika 2.2.1 (ii) lidhur me referencat e sektorit privat, i ka kërkuar sqarime Operatorit Ekonomik të shpërblyer me kontratë qe të arsyetoj të gjitha referencat e natyrës se ngjashme në sektorin privat duke i kërkuar si vijon:

“Për Projektet e paraqitura në listë dhe në aneksin kontrata) të lidhura nga ana e juaj dhe kompanive private ju kemi dorëzuar kontrate dhe reference mirëpo për dallim nga kontrata shtetërore që njafton Referenca / projektet që lidhen me sektorin privat duhet të dëshmohen edhe përmes transaksioneve bankare. Kështu që ju duhet të bashkëngjisni Transaksionet bankare, dhe dokument tjetër dëshminë(faturat) për vlerë e paraqitura sipas listës se kontratave, dhe aneksi 1”.

OE ne kthimin e kërkesës të paraqitur nga AK me datë 30.01.2025 / brenda afatit kohor ka arritur të paraqes dëshmi dhe kompetencë se ka realizuar kontrata të natyrës se ngjashme ku i ka vërtetur me raporte të pranimit teknik, kontrata, referenca dhe për të gjitha referencat e sektorit privat i njëjti ka paraqitur dokumentacion si: Faturat e nënshkruara, të nënshkruara e vulosura nga blerësi, e të gjitha këto të vërtetuar me Libra të Shitjes dhe me Konfirmime apo transaksione të pagesave. I njëjti operator ekonomik për secilin referencë ka paraqitur edhe nga një raport në mes transaksioneve bankare dhe faturimit nga ana e tij.

Të gjitha faturat e paraqitura nga ana e Operatorit Ekonomik janë fatura të Realizimit të punimeve sipas kontratave, realizimi i punëve në objektin përkatës dhe të ngjashme. Për secilin nga projektet i njëjti e ka paraqitur me arsyttime se cilat punë janë kryer, duke paraqitur

fotografi gjatë realizimit të punëve dhe fotografi të objekteve të realizuara dhe se komisioni vlerësues ka klasifikuar se i gjithë dokumentacioni është në përputhje me kërkesat e Autoritetit Kontraktues.

Eksperti shqyrtues lidhur me pretendimet e përmendura si me larte, sqaron se vlera e ofruar nga i rekomanduari për kontratë është afër 30,000,000.00 euro, ndërsa vërtetimi nga banka është sipas kërkesës së dosjes së tenderit (DT).

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se i rekomanduari për kontratë nuk ka ofruar kontratë dhe referencë sipas kërkesës së dosjes së tenderit, eksperti shqyrtues sqaron se në ofertën e tij OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar listën e kontratave dhe dëshmitë; referencë, pranime teknike në vlerë prej: afër 31,000,000.00 euro. Prandaj eksperti shqyrtues sqaron se nuk qëndron ky pretendim.

Pergjigja e ekspertit –ku ka konstatuar se qdo reference e prezantuar nga kompania jone si OE-i pergjegjshem eshte e pranueshme dhe e pakontestueshme, pasi qe per secilin kemi qene ne gjendje te ofrojmë te gjitha sqarimet e nevojshme dhe kemi deklaruar se ato jane te pranueshme dhe te ngjajshme me projektin ne fjale dhe qe për qdo projekt kemi ofruar sipas kërkeses per sqarim nga AK , faturat, transaksionet bankare , librin e shitjes situacionet e nevojshme.

Me kete vertetojme qe qdo projekt i jone i ofruar ne listen e dosjes se tenderit ka qene i pranueshem nga OSHP per AK tjeter, duhet qe edhe per ju poashtu si AK të jenë të pranueshme. Po ashtu OSHP ne vendimin e dates 02.04.2025 ka thene qe te shqyrtohet edhe njehet oferta jone dhe te merren si e mirëqenë si dhe te anulohet vendimi per anulimin e aktivitetit, e ju si AK nuk keni marr mundin as te beni asnje kerkese per sqarim sepaku pas vendimit te OSHP se dates 02.04.2025 dhe të kërkonë dokumentacionin e nevojshëm per verifikime te projekteve siq ka ndodhur ne AK tjera kontraktuese.

Pjesa 2. Anulimi i aktivitetit

Po ashtu, AK këtu ka vepruar edhe në kundërshtim me nenin: 62 të LPP. ku thekson:

Neni 62

Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

1. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërin nga arsyet:

1.1. një shkeljeje të ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodhë në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

2. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërin nga arsyet:

2.1. të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo

2.2. para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve.

Sipas kesaj AK ka bere shkelje te ligjit pasiqe pas gjithë ketyre proceseve ka bere anulimin e aktivitetit te prokurimit .

Duke i parë shkeljet e paraqitura ne detaje të:

- A. Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092
- B. A01. Rregullore Nr.001/2022 për Prokurimin Publik
- C. A02. Udhëzues Nr-001/2023 per prokurimin publik

I propozojme Autoritetit Kontraktues Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë:

- I. Kërkesën për rishqyrtim të paraqitur nga BM GROUP SHPK / t'a vlerësoi si të BAZUAR.
- II. Të ANULOI – Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues – Formularin B58 të datës 28.05.2025

Aktivitetin e prokurimit: Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente ne QKUK" me numer: 206-23-14371-5-1-1 i ta kthei në RIVLERËSIM

Përgjigja e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimet ankimore te Grup i OE Mabco Constructions & AAG Projekt & IMK,:

Me qellim te korrektësisë dhe transparencës si AK ndaj juve si OE ankues, po e trajtojmë Kërkesën tuaj për Rishqyrtim edhe pse bazuar ne vendimin e OSHP-se me Nr. 2024/1186, ankesa juaj ne OSHP me numër 2024/1200, nga ana e OSHP eshte aprovuar si pjesërisht e bazuar, duke i evidentuar mangësitë e ofertës tuaj, andaj AK-MSH pretendimet e juaja i konsideron te gjykuara "res judicata" dhe bazuar ne vendimin e fundit te OSHP-se te datës 02.04.2025 oferta juaj nuk eshte shqyrtuar nga komisioni gjate rivlerësimit, bazuar ne konstatimet e Panelit Shqyrtues:

Lidhur ankesën me nr me nr. 2024/1200 "Mabco Constructions Sh.P.K.& AAG Projekt & Imk - Industria Metalike e Kosovës SH.P.K."

Paneli Shqyrtues do të lëshohet vetën në pretendimet ankimore të cilat janë të përcaktuar në këtë vendim dhe në këtë raste mbështet raportin ekspertit shqyrtues dhe / teknik ngase në ofertën e këtij OE ankues ne Planin Dinamik të ofruar mungon përshkrimi i punimeve tek H4- ku nuk janë të përfshira (mungojnë) 14 pozicione. Sipas DT se ku është e paraqitur forma 1 dhe 2 lidhur me Planin Dinamik ky OE ka përdorur vetëm formën 1 por jo edhe te plotësuar ngase siq u tha edhe me larte mungon përshkrimi i dinamikës ne realizimin e punimeve nga H4 , në 14 pozicione, ndërsa forma 2 nuk gjendet fare, kështu që ky Plan i ofruar nga ankuesi, nuk është ofruar sipas kërkesës së DT dhe si i tillë nuk ofron të dhëna të sakta rreth implementimit të këtij projekti, përshirë edhe afatet e ekzekutimit të punëve. Kështu që, konform nenit 10 të Udhëzuesit për Prokurim Publik, Kur lista e çmimeve nuk është plotësuar, refuzo tenderin pa kërkuar informacion shtesë- Kusht administrativ. PSH konsideron se AK ka vepruar konform dispozitave ligjore për eliminimin e këtij OE ankues.

Përgjigja e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimet ankimore te Grup i OE ADA & SHM Arch & Vëllëzërit Asllani:

Me qellim te korrektësisë dhe transparencës si AK ndaj juve si OE ankues, po e trajtojmë Kërkesën tuaj për Rishqyrtim edhe pse bazuar ne vendimin e OSHP-se me Nr. 2024/1186, ankesa juaj ne OSHP me numër 2024/1186, nga ana e OSHP eshte aprovuar si pjesërisht e bazuar, duke i evidentuar mangësitë e ofertës tuaj, andaj AK-MSh pretendimet e juaja i konsideron te gjykuara "res judikata" dhe bazuar ne vendimin e fundit te OSHP-se te datës 02.04.2025 oferta juaj nuk eshte shqyrtuar nga komisioni gjate rivlerësimit, bazuar ne konstatimet e Panelit Shqyrtues:

Lidhur me ankesen e OE "Ada Consulting Group SH.P.K" me numër protokolli 2024/1186

Paneli Shqyrtues mbështet raportin e ekspertëve shqyrtues / teknik lidhur me raportin ngase kanë gjetur se i njëjti ka ofruar dëshmi kontratën me QKUK për vazhdimin e punimeve në klinikën e Ortopedisë, ku sipas raportit për pranim teknik janë edhe "Dyer Hermetike INOX me veshje Plumbi". Përveç kësaj OE ankues ka ofruar vetëm një raport për pranim të pjesshëm të punëve, i cili raport shënon: komisioni gjatë punës ka verifikuar funksionimin e dyerve, instalimeve elektrike etj...dhe se komisioni ka kërkuar përmirësimin e vërejtjeve të evidentuara gjatë punës në terren dhe se raporti i ofruar nuk është në pajtim me kërkesat e dosjes së tenderit, pasi që OE nuk ka dorëzuar pranimin teknik final të projektit para afatit të fundit të dorëzimit të ofertave edhe pse OE ankues pretendimin e tij e mbështet në faktin se punimet lidhur me dyert X-ray janë kryer më herët se afati i fundit për dorëzim të tenderit mirpo nese i referohemi kërkeses se Dosjes se Tenderit, Njoftimit per kontrate dhe Formularit per permirisimin e dosjes ka qenë për "projekte të realizuara", dhe sipas vlerësimit tonë asnjë projekt nuk mund të quhet i realizuar nëse për atë projekt nuk ka pranim final/përfundimtar nga ana e AK-së. Në rastin konkret dëshmia (pranimi final) nuk ka ekzistuar para datës së hapjes së ofertave ngase AK -ja gjate rivlersimit të ofertave sipas vendimit te OSHP -se me nr 2024/0352, 2024/0360, 2024/0362, 2024/0367, ku eshte kerkuar aplikimi i nenit 72 të LPP se AK ja gjate rivlersimit të ofertave ka kerkuar sqarime tek Klinika e Ortopedise -QKUK, dhe ne pergjigjen e marur rezulton se ky OE nuk ka ofruar ndonje raportë te pranimin teknik si rezultat i projekti te perfunduar me sukses sikurse është kerkuar. Andaj, PSH konsideron se ky OE ankues nuk ka ofertuar konform kërkesave të NJK/DT.

Përgjigja e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimet ankimore te OE BM Group SH.P.K.:

Me qellim te korrektësisë dhe transparencës si AK ndaj juve si OE ankues, po e trajtojmë Kërkesën tuaj për Rishqyrtim edhe pse bazuar ne vendimin e OSHP-se me Nr. 2024/1186, ankesa juaj ne OSHP me numër 2024/1232, nga ana e OSHP eshte aprovuar si pjesërisht e bazuar, duke i evidentuar mangësitë e ofertës tuaj, andaj AK-MSh pretendimet e juaja i konsideron te gjykuara "res judikata" dhe bazuar ne vendimin e fundit te OSHP-se te datës 02.04.2025 oferta juaj nuk eshte shqyrtuar nga komisioni gjate rivlerësimit, bazuar ne konstatimet e Panelit Shqyrtues:

Lidhur ankesën e OE "BM Group" me numër protokoli 2024/1232

Paneli Shqyrtues e mbështet raportin e ekspertit shqyrtues dhe/ teknik sikurse edhe vendimin e AK-se ngase Pretendimet ankimor të OE ankues të cilat kanë të bëjnë me arsyen e eliminimit, ku sipas AK-së i njëjti nuk plotëson kërkesat për kapacitet teknik profesional lidhur me kontrata dhe referencat e BM Group janë trajtuar përmes raportit të ekspertizës nr.367/24. Kërkesa e parashtruar nga AK sipas Njoftimit për Kontrate, Dosjes së Tenderit si dhe Formularit për korigjimin e procedurës e publikuar në platformën elektronike për këtë aktivitet të prokurimit lidhur me kërkesat mbi përshtatshmërinë profesionale/ teknike ku është kërkuar që "Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka realizuar me sukses projekte të ngjashme- ndërtim ose renovim i objekteve të larta, në vlerë të përgjithshme jo më pak se 25 Milion Euro, gjatë periudhës së shkuar tre vjeçare deri në Njoftimin për Kontratë. Në rast të konsorciumit, së paku 50% e punëve të përfunduara kërkohet për liderin e grupit. Së paku në njërin projekt të jenë kryer punime lidhur me X- ray, Gaz medicinal, ventilim, klimatizim, dyer X-ray Automatike, etj." Lidhur me projektet e paraqitura në ofertë sikurse : Ndërtimi i Stadionit të qytetit në Gjiçan, Faza e parë - Renovimi i stadiumit në Gjakovës, Faza e dytë - Ndërtimi i stadiumit të qytetit Drenas, Ndërtimi i Parkut Industrial në Miradi, ndërtimi i Fakultetit të FSHMN-së - Prishtinë, Ndërtimi i stadioneve ndihmëse në Gjiçan, Pejë, Drenas dhe Studençan, Furnizimi dhe ekzekutimi i punëve në parkingut në Prishtinë, Ndërtimi dhe furnizimi i ndërtimit në Lagjen Marigona Hill, Furnizimi me beton për ndërtimin e objekteve afaristo-banesore për Pozhegu Brothers. Për të gjitha këto projekte ky OE ankues ka prezantuar kontratë dhe referenca, të cilat nuk dëshmojnë realizimin/përfundimin e suksesshëm të këtyre projekteve ashtu siq përshkruet edhe në raportin e ekspertit shqyrtues/teknik se në këto referenca shënon "Referencë pozitive ... prej fillimit të kontratës deri më sot...", "realizim i punimeve deri në masën 85%", "... në punimet që po zhvillohen ...", "... me sukses e ka përfunduar pjesërisht furnizimin ...", e të ngjashme. Duke u bazuar në këto konstatime, me të cilat vërtetohet se OE i kontraktuar nuk ka përfunduar në tërësi punët sipas marrëveshjes kontraktuale, pastaj kontrata me vetëm furnizim, si dhe kontrata të kombinuara furnizim dhe punë, rezulton që OE Ankues nuk e arrin shumën e kërkuar me dosje të tenderin në vlerën prej 25.000.000.00 euro. OE ankues nga AK, në listën e projekteve të realizuara ka 25 projekte, ndërsa tek referencat ka 23 sosh, meqë në 2 (dy) prej tyre ka anekse kontrata.

Gjatë elaborimit të tyre është vërejtur: 2 (dy) Referenca (Demolation and Landscaping Central Vaccine dhe Ndërtimi i Fakultetit Ekonomik dhe FSHMN-së) nuk kanë nënshkrim, prej tyre njëra (1) nuk ka çmim të përshkruar (Demolation and Landscaping Central Vaccine) dhe tjetra është realizuar deri në masën 85% (Ndërtimi i Fakultetit Ekonomik dhe FSHMN-së); 1 (një) tjetër është në proces e sipër (Punimet në Parkun Industrial në Drenas); 1 (një) është vetëm furnizim (Furnizimi për ndërtimin e objektit afaristo-banesor të investitorit Pozhegu Brothers). Bazuar në gjitha këto që u cekën më lart, sikurse në raportin e eksperti shqyrtues/teknik vlerësojnë se pretendimet ankimore se OE i ankues për kontratë nuk plotëson kërkesën për punë të ngjashme në vlerë 25.000.0000 ashtu siq janë kërkuar kështu që Paneli Shqyrtues vlerëson se ky OE nuk ka përmbyllur kërkesën siq është kërkuar në NK,DT konform nenit 69 të LPP-së, "projekte të realizuara" andaj asnjë projekt i cili nuk është i përfunduar në tërësi nuk mund të konsiderohet si projekt i realizuar, dhe asnjë shumë nga ato projekte të papërfunduara nuk mund të pranohet si referencë në rastin konkret, këtë e ka vërtetuar edhe AK-ja gjatë rivlersimit të ofertave, sikurse është e përshkruar në B58 Njoftim mbi vendimin e AK-se tek letra standarde për tenderuesin e eliminuar. Andaj, PSH konsideron se ky OE ankues nuk ka ofertuar konform kërkesave të NJK/DT.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorëzohet brenda 10 (dhjete) ditëve pas pranimit te këtij vendimi.**

Vendimi i dorëzohet:

1. Grup i OE Mabco Constructions & AAG Projekt & IMK
2. Grup i OE ADA & SHM Arch & Vëllezërit Asllani
3. BM Group Shpk
4. Operatoreve ekonomik dhe paleve te interesuara



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit